

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 14 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Është e disata javë, madje prej muajsh që Kryeministri nuk vjen në seancë. Jo se na merr malli dhe e duam, madje ne bëjmë çfarë të jetë e mundur për t'ia shkurtuar ditët e qeverisjes, prania e tij nuk është aq e mirëpritur për ne, si opozitë, por është detyrim për llogaridhënien para këtij parlamenti, i cili është votuar nga qytetarët dhe për të rrëzuar skandalet e publikuara, në mënyrë të njëpasnjëshme në medie dy javët e fundit, skandale të konfirmuara në mënyrë precize dhe profesionale nga të gjitha strukturat ndërkombëtare. Me sa duket Edi Rama nuk ka se çfarë të thotë për skandalet e përditshme që janë në Shqipëri, prandaj ka braktisur parlamentin, fyen qytetarët që e kanë zgjedhur, duke e abandonuar në mënyrë të përhershme dhe duke u sjellë si monark, i cili nuk ka lidhje me një republikë parlamentare.

Për ligjin që keni sjellë, ashtu siç një prej ministrave e tha pak më parë, nuk besoj se as ju nuk prisni që nëpërmjet tij të ketë dhe t'i japim të rinjve dhe njerëzve mundësi që të krijojnë dhe të kenë inovacion. Ky ligj duhet thënë qartë se vjen vetëm për llogari të oligarkëve të caktuar dhe pyetja që shtrohet në këto momente, edhe nga qytetarët është të na thonë njerëzit që përfitojnë me emra konkretë nga ky ligj, që të bëhen të ditur para publikut dhe qytetarëve shqiptarë që do të përfitojnë miliona euro, do të përfitojnë përsëri para publike duke iu shmangur taksave, do të përfitojnë prona dhe toka publike, do të përfitojnë, ashtu siç përfituan me ligjin e investimeve strategjike të gjithë njerëzit mbështetësit ose familjarët e qeveritarëve dhe deputetëve të Partisë Socialiste.

Vazhdoni me të njëjtën metodë, siç keni kaluar ligje të tjera, kujtoj këtu ligjin e famshëm për teatrin, ligjin për Butrintin, siç parashikoni të jepni Amfiteatrin e Durrësit, siç parashikoni të jepni pronat në Drilon. Unë mendoj se e vetmja gjë ku jeni inovator dhe keni inovacion është se jeni magjistarë, këtë besoj jua njohin edhe qytetarët shqiptarë, sepse i shumëfishoni paratë për vete. Po patët ndonjë gjë të vogël bëni namin, nxirrni edhe medien, por tani rrini të gjithë të heshtur: as qeveria, as deputetët e Partisë Socialiste nuk kanë reagim. Një drejtor i rëndësishëm i kësaj qeverie blen kompani për 70 euro dhe e shet në më pak se në një vit për 1,8 milionë euro. Pra, jemi këtu jo në kushtet e inovacionit, por të magjistarit të madh se si prodhohen para. Fillojnë punët publike me 50 milionë euro.

Nuk e kisha parë rrugën Kardhiq-Delvinë, mendova se do të kishit bërë ndonjë mrekulli të madhe përderisa janë shpenzuar 108 milionë euro, por, në fakt, rruga që keni bërë është rrugë me standarde si rrugët e fshatit, një rrugë me një tunel si një vrimë miu, ndjesë që po përdor këtë fjalë, por mezi hyje dhe mezi dilje, ishte i shkurtër ndërkohë që paratë që janë harxhuar për të janë 108 milionë euro. Tuneli tjetër 7 kilometër 210 milionë euro. A ka këtu përgjegjësi për të dalë Kryeministri dhe për t'iu dhënë llogari deputetëve dhe qytetarëve shqiptarë për këto para që shpërdorohen? Meqenëse jemi sot në ditën e drejtësisë, meqë raportoni të gjitha institucionet e drejtësisë, a kanë përgjegjësi këto institucione?

A kemi ne detyrën, ashtu siç edhe publiku, për t'i gjykuar? Unë kam qenë një ndër njerëzit që në këtë Kuvend në seanca të kaluara kam votuar pro vetingut vetëm për të hequr propagandën, por edhe për të besuar, pa diskutim, që besoj më shumë te specialistët ndërkombëtarë të ONM-së ose tek institucionet shqiptare për t'u hequr çdo lloj propagande. Ku jemi sot? Ai që mbahet si nona e drejtësisë, është vetë nona e përfshirjes në krim. A i ka çuar atij ish-ministrit të Brendshëm, që del dhe bën si reformator i madh i, Ministrisë së Brendshme, për shkak të aktit normativ, që njihet si OFL-ja, një shkresë siç ua ka dërguar të gjithë njerëzve të tjerë, apo jo? Apo disa janë të nënës dhe disa të njerëzve dhe ligji nuk është i barabartë për të gjithë, sepse disa janë më të barabartë se të tjerët në këtë vend?

A ka sot ndonjë qytetar shqiptar që kur dëgjon, me të drejtë, besoj unë, shifrat modeste që raportuan institucionet e drejtësisë, 17 të dënuar në SPAK, kaq të dënuar këtu dhe kaq dënuar

aty, ndërkohë që nuk ka të dënuar dhe pandëshkueshmëria është kthyer në një model në këtë vend, sepse ata thonë jo se ka disa njerëz që kanë hyrë këtu se kanë qenë ish-ministra dhe ish-deputetë? Jo, ata janë njerëz pa mbështetje politike dhe ne duhet t'u themi të vërtetën, ashtu siç ka tani ajo drejtësia e vjetër, e shkatërruar, e rrënuar, e dënuar apo e korrumpuar, mund ta quani si të doni ju, ka pasur ish-ministra të dënuar, madje më shumë sesa ish-ministri i dënuar tani, me burg për një çështje, jo për shpërdorim detyre, dhe shumë zyrtarë të lartë, mbi 370.

Çfarë do të thotë kjo, që për këto miliona euro që janë hedhur në të themi që po funksionon? Më pas dëgjova këtë pjesën tjetër nga pjesa më e madhe e deputetëve të Partisë Socialiste që drejtësia duhet të funksionojë për të gjithë. Si do të funksionojë? Ne duart në xhepa dhe fjalën kemi. Për çfarë? Ku? Ka pasur ish-ministra në anën tonë, por janë bërë 9 vjet dhe ju çfarë keni bërë? Me të drejtë ata mund të kenë besuar, edhe unë mund të jem një prej tyre, po, ka pasur korrupsion në qeverisjen e kaluar, por gjatë këtyre 9 vjetëve a ka dërguar ndonjë për kallëzim kjo qeveri? A i ka marrë si model disa ish-ministra të Partisë Demokratike, duke i dërguar në institucione më të rëndësishme qoftë kombëtare apo ndërkombëtare?

Kujt t'i dërgojmë në llogari? Kujt do t'i kërkon ju që keni 9 vjet në qeverisje, sepse ne me të drejtë mund t'ju kërkomë ju, madje mund t'ju kërkojmë edhe për këtë pjesën këtej ku jemi ulur edhe ne, pse nuk i keni mbajtur të gjitha premtimet elektorale që keni bërë para votuesve tuaj dhe para qytetarëve shqiptarë në raport me ndëshkueshmërinë? A ka këtu një marrëveshje të heshtur? Ju bëni zhurmë kot këtu me institucione të kota për t'u hedhur hi syve qytetarëve shqiptarë. Duhet të jemi të vërtetë, sepse ndërkohë që ndëshkueshmëria nuk ka ndonjë rritje, krimi ka rritje më të madhe. Sipas prokurorit të Përgjithshëm krimi kishte rritje, por ju në vend që ta mbështesni thoni një mijë e një variante.

Nga ana tjetër, shikojeni sot raportin, sipas Eurostatit, ku Shqipëria është turp pa diskutim dhe nuk më vjen mirë që e them, por edhe juve nuk ju vjen mirë kur e shikoni, është kokë më kokë me Rusinë për korrupsion, e fundit. Po ashtu edhe sipas raportit të "Transparency International", sipas raporteve të OKB-së, sipas raporteve për drogat dhe raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Çfarë shteti po ndërtojmë ne? Shtet pambuku, se shtet nuk mund t'i thuhet, apo jo, ku vjen i forti, ai që ka më shumë fuqi, i mbyt gjithë të tjerët dhe më të

dobëtit i merret fryma. I kemi denoncuar rast pas rasti dhe shikoni pak se çfarë ka ndodhur, komplet magji dhe magjistar!

Shikojeni pak se si ngjallet i vdekuri dhe bën të pasur këta që janë gjallë; shikojeni pak se si pasurohen qeveritarët nga ajo që mbledh kanaçe, e cila nuk ka bukë të hajë, por ka mundësi të pasurojë me miliona euro këta që janë në qeveri. Nuk ka reagim, ka heshtje, Kryeministri nuk flet dhe nuk del ta sqarojë, institucionet e drejtësisë nuk reagojnë, të cilat pa diskutim ne i inkurajojmë, sepse nuk duam të cenohet besimi i publikut, por këto janë fakte që nuk i shmangim dot. Shikojeni pak (sepse e shoh që po më mbaron koha dhe më pas është ministri i Mbrojtjes) se çfarë magjistarësh janë, duke përdorur atë anekdotën e famshme: çfarë bën qeveria kur bie zjarr?

E lë të bjerë dhe të vazhdojë. Kemi dërguar 100 zjarrfikës, thotë ministri, por del prefekti dhe e përgënjeshton duke thënë: po, kemi 100 njerëz, por të 100-të nuk i çojmë dot te mali i Çikës, se është mal i thepisur dhe rrimë e presim këtu poshtë. Pas 4 ditësh, ndërkohë që ne u themi që duhet të ketë ndonjë avion për të fikur zjarrin, sepse është më mirë që të ketë një avion sesa të ketë një avion me dhoma gjumi që të fluturojë Edi Rama me mijëra euro, ju nuk e thoni dot. Në të kaluarën mund të thoshit që kanë qenë temperaturat e larta dhe kjo ka sjellë vështirësi, por këtë vit temperaturat kanë qenë si në periudhën e vjeshtës, ndërkohë që zjarri ka 4 apo 5 ditë ka rënë ju tani u zgjuat dhe reaguat? Shyqyr që u zgjuat! Thatë që do të vijnë 2 avionë, le ta shohim, por ndërkohë mos i dërgoni kot njerëzit atje.

Të paktën këtë herë, hajdeni, të duket sikur po punojmë edhe ne dhe të mos thoni që nuk duam bashkëpunim, të marrim nga një lopatë të dy, gjethe dhe këta të tjerët dhe të përpiqemi ta fikim zjarrin. Faleminderit!